



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39 regjistër (JR)
Datë 04.09.2019

Nr. 5 i vendimit
Datë 12.02.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 12.02.2021, ditë e premte, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 178, datë 08.07.2019.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 e vijim; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, nenet 136, 136/1, 136/3, 139 e vijim; ligji ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016, nenet 136/113/5, 139, 139/2, 179/4, 179/b, 179/b/2, 179/b/5, neni G e vijim; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e vijim; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63, 4/6, 47, 3/16, 58/1, 66/1/c e vijim; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 46 e vijim; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 1, 3, 5, 7, 11, 12, 22, 36, 61, 62, 64, 65 e vijim.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, e cila përfundimisht, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 178, datë 08.07.2019, për pikën 2 të tij, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016¹ dhe të ligjit nr. 84/2016², ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Lartë. Bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*. Çështja u shortua në Komision në datën 15.03.2019. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.03.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ për procedurën e rivlerësimit.
2. Trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, datë 29.06.2017, vendosi deklarinimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë për znj. Evelina Qirjako.
3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 66, datë 24.04.2019, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistrates së ish-gjyqtares së Gjykatës së Lartë, znj. Evelina Qirjako, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli.
4. Komisioni, pasi u informua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për vendimin nr. 66, datë 24.04.2019 dhe mbi praktikën e ndjekur për dhënien e këtij vendimi, më datë 08.07.2019 vendosi të ndërprerë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, me vendimin nr. 178, datë 08.07.2019, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, vendosi:
 1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, është ndërprerë.
 2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të

¹ Ligji nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, datë 27.07.2016. Ligji ka hyrë në fuqi më datë 11.08.2016.

² Ligji nr. 84/2016, përfundimisht, filloi zbatimin më datë 19.01.2017, ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 5 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

[...]

III. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit. Ankimi mbështetet në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”), në nenet 136, 136/1, 136/3, 139 e vijues të Kushtetutës, të miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, në nenet 136/113/5, 139, 139/2, 179/4, 179/b, 179/b/2, 179/b/5, në nenin G e vijues të Kushtetutës, të miratuar me ligjin ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016, në nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative (në vijim “K.Pr.Administrative”), në nenet 63, 4/6, 47, 3/16, 58/1, 66/1/c e vijues të ligjit nr. 84/2016, në nenin 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), në nenet 1, 3, 5, 7, 11, 12, 22, 36, 61, 62, 64, 65 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”).
7. Ankimi ka për objekt kundërshtimin e pjesshëm të vendimit nr. 178, datë 08.07.2019, të Komisionit, vetëm për pikën 2 të dispozitivit, lidhur me deklarinimin e humbjes së të drejtës së subjektit, për 15 vite, për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pika 2 e dispozitivit të vendimit të Komisionit është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe material. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, nuk ankimon pikën 1 të dispozitivit pasi, sipas saj, kjo pikë nuk e ka cenuar në jetën familjare dhe karrierën e saj, dhe pasqyron atë çfarë i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme Komisionit. Subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të konstatojë dhe të riparojë përcaktimin e bërë nga Komisioni në pikën 2 të vendimit me argumentet e mëposhtme ligjore.
 - 7.1. Lidhur me shkeljet e ligjit procedural, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit pretendon se:
 - veprimtaria e Komisionit nuk është bazuar në asnjë nga parimet e parashikuara në Kushtetutë dhe në K.Pr.Administrative, që lidhen me parimin e transparencës, informimit, objektivitetit, drejtësisë dhe paanësisë, komunikimit me palët, si dhe me ushtrimin e të drejtave, si e drejta për t’u njohur me materialet e dosjes dhe për të marrë një kopje të tyre, e drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime në lidhje me çështjen, e drejta për të bashkëpunuar gjatë hetimit administrativ, e drejta për të kërkuar prova dhe dokumente të tjera, e drejta për të paraqitur prova dhe informacione, e drejta për t’u dëgjuar për provat e paraqitura në çdo formë të përshtatshme me shkrim apo me gojë;
 - Komisioni ka vepruar në shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, pasi ajo [subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako] nuk është pyetur dhe as është dëgjuar nga Komisioni për pikën 2 të dispozitivit të vendimit, për sa

kohë që ky parashikim sjell pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda ndaj saj. Procedura e ndjekur ishte me të meta.

7.2. Sa i përket mënyrës se si Komisioni ka zbatuar ligjin material – duke iu referuar pikës 2 të dispozitivit – në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit pretendon se: vendimi është konfuz, i marrë në bazë të provave dhe fakteve që nuk ekzistojnë, në mungesë të plotë të analizës logjike dhe juridike, si dhe mbi konkluzione të pabazuara në ligj. Këtë pretendim subjekti i rivlerësimit e ka parashtruar në formën e pyetjeve³, për të cilat ka dhënë edhe argumentet përkatëse, dhe përmbledhtas:

- Sipas ndryshimeve të Kushtetutës [me ligjin ndryshues nr. 76/2016], a mundej ajo të vazhdonte ushtrimin e detyrës si gjyqtare e Gjykatës së Lartë edhe pas përfundimit të mandatit të saj?
- Kur fillonte dhe kur mbaronte statusi i saj si magjistrate, në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Lartë, dhe a kushtëzohej ai nga mbarimi i mandatit të saj 9-vjeçar?
- A mund të penalizohet ajo nga mosaplikimi i një të drejte të dhënë nga ligji dhe a është i zbatueshëm në rastin konkret apo i parashikuar në ligj sanksioni që përbën pika 2 e dispozitivit të vendimit të Komisionit nr. 178/2019?

7.2.1. Sa i përket çështjes nëse subjekti i rivlerësimit mund të vazhdonte ushtrimin e detyrës së gjyqtares së Gjykatës së Lartë edhe pas përfundimit të mandatit, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, në mënyrë të përmbledhur, argumenton se:

- Komisioni nuk ka marrë parasysh parashikimet e Kushtetutës dhe të kuadrit ligjor në fuqi që rregullojnë qëndrimin në detyrë të gjyqtarëve që kishin fituar mandatin sipas parashikimeve të mëparshme të nenit 136 të Kushtetutës dhe të kuadrit ligjor në fuqi në kohën e emërimit.
- Komisioni nuk ka respektuar parimin e kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve pasi u referohet akteve dhe provave që nuk ekzistojnë e që vijnë në kundërshtim me ligjin.
- Komisioni nuk ka tagër të vlerësojë nëse i ka përfunduar mandati gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të përcaktojë nëse gjyqtari duhet të rrijë apo jo në detyrë përtej mandatit të tij, të shprehet nëse gjyqtari i Gjykatës së Lartë, pas përfundimit të mandatit, e gëzon apo jo statusin e magjistratit.
- Komisioni ka vepruar përtej kompetencave dhe ka shkelur parimin e zhvillimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi përmendja në vazhdim dhe në mënyrë të përsëritur në shkresën e datës 14.05.2018, e parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me dorëheqjen nga detyra, pa u caktuar trupi gjykues dhe pa filluar procedurat e rivlerësimit, tregon se çështja, procesi dhe përfundimi kanë qenë të paragjykuar.
- Komisioni përfundoi procesin duke aplikuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës, edhe pse një sanksion i tillë nuk parashikohet në ligj për rastin e saj dhe të kolegëve të saj, pasi ata nuk ndodheshin më në detyrën që kishin ushtruar.

³ Pyetjet e parashtruara në ankim, janë tekstualisht: “[...] **A.** A mund të vazhdoja unë në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Lartë ushtrimin e detyrës edhe pas përfundimit të mandatit tim kushtetues, sipas parashikimeve të ligjit 76/2016? **B.** Kur fillonte dhe kur mbaronte statusi im si magjistrate në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Lartë? A përfundonte statusi im për efekt të ligjës, me mbarimin e mandatit tim kushtetues 9-vjeçar? **C.** A mund të penalizohesh nga mosaplikimi i një të drejte të dhënë nga ligji? A është i zbatueshëm në çështjet konkrete dhe a është i parashikuar në ligj sanksioni i dhënë nga trupi gjykues i KPK-së në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 178, datë 08.07.2019 [?]”.

7.2.2. Lidhur me çështjen e dytë – kohën kur filloi dhe mbaroi statusi i magjistrates së subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, dhe raporti me mandatin 9-vjeçar në cilësinë e gjyqtarës në Gjykatën e Lartë – pas analizës së parashikimeve kushtetuese, ligjore dhe situatës faktike, subjekti i rivlerësimit konkludon se mandati 9-vjeçar ka përfunduar sipas parashikimit ligjor. Sipas kësaj analize të parashtruar prej saj, ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 nuk lejonin qëndrimin tej mandatit të mëparshëm. Statusi i magjistrates ka përfunduar për efekt të ligjit me përfundimin e mandatit, duke nënkuptuar që ajo kështu ka fituar statusin e ish-anëtares së Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, duke mos qenë në detyrë, subjekti argumenton se nuk mund të ishte më subjekt i ligjit nr. 84/2016. Në mënyrë të përmbledhur, argumenton se:

- Vendimit të Komisionit i mungon analiza ligjore, është konfuz dhe nuk ka rrjedhë logjike (referuar paragrafëve 23 – 28) e, për rrjedhojë, Kolegji duhet të shqyrtojë dhe të vendosë për të gjitha shkaqet e ngritura në ankim.
- Komisioni që vepron si një *quasi gjykatë*, duhej të interpretonte drejt faktet dhe ligjin, pasi shkaku për përfundimin e statusit të magjistratit për ish-anëtarët e Gjykatës së Lartë, i shprehur në vendimin e KLGj-së, nuk është i parashikuar nga neni 64 i ligjit nr. 96/2016.

7.2.3. Sa i përket pyetjes së tretë, që lidhet me shkakun e mbarimit të statusit për atë vetë dhe bazueshmërinë në ligj të vendimit të KLGj-së apo të sanksionit të zbatuar për të nëpërmjet vendimit të Komisionit nr. 178/2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, argumenton se statusin e magjistrates e kishte humbur për shkak të ligjit, për shkak të mbarimit të mandatit. Elementet që e përbënin atë, nuk ekzistonin më tej, pavarësisht deklarimit prej saj në KLGj se nuk dëshironte të aplikonte në një pozicion në nivel gjykate apeli. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, parashtron se:

- shkaku ligjor i gjetur nga KLGj-ja është i pabazuar në ligj dhe në situatën faktike juridike;
- neni G i Aneksit të Kushtetutës nuk mund të aplikohet, pasi në momentin kur filloi procesi i rivlerësimit [21.03.2019], ajo kishte gati 2 vite që ishte larguar nga Gjykata e Lartë për shkak të mbarimit të mandatit, nuk gëzonte më statusin e gjyqtarës dhe ushtronte profesionin e avokates;
- baza ligjore e përdorur nga Komisioni për zgjidhjen e çështjes është e pazbatueshme dhe përbën shkelje të rëndë të parimit që gjykata e zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin;
- është zbatuar gabim një dispozitë ligjore që nuk ka lidhje me situatën juridike të krijuar për të kur i ka mbaruar mandati 9-vjeçar si anëtare e Gjykatës së Lartë;
- Komisioni e ka penalizuar mbi bazën e një të drejte që i ka dhënë vetë ligji, e ka dalë jashtë tagrave të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur vendos penalitete për individë që nuk janë subjekte të ligjit;
- Komisioni ka përdorur standarde të dyfishta për situata të njëjta, gjë që e bën vendimin të dyshimtë, të njëanshëm, të cenueshëm dhe të paragjykuar;
- penaliteti i përjashtimit nga drejtësia nga organet e *vetting*-ut në shoqërinë shqiptare e stigmatizon dhe ndikon drejtpërdrejt në jetën profesionale, duke i krijuar probleme edhe në karrierën private;
- Komisioni ka shkelur hapur njërin prej parakushteve të proporcionalitetit, siç është legjitimitimi i masës, duke vendosur një masë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, me praktikën e GjEDNj-së dhe qëndrimin e shprehur në KEDNj lidhur me masën e kufizimit.

8. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji të vendosë prishjen dhe pushimin e gjykimit, për sa i përket pikës 2 të dispozitivit të vendimit nr. 178, datë 08.07.2019.
9. Bashkëlidhur ankimit, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ka bashkëlidhur 18 akte në mbështetje të pretendimeve të saj, të cilat pretendon se Komisioni nuk i dha mundësinë t'i paraqiste gjatë gjykimit, si në vijim.
 - 1) Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 5793, datë 08.07.2008, për emërimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, anëtare e Gjykatës së Lartë.
 - 2) Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nr. 208, datë 28.07.2008, në funksion të emërimit të saj në të njëjtën detyrë.
 - 3) Vërtetim nga Gjykata e Lartë nr. {***} prot., datë 21.02.2011, sipas të cilit znj. Qirjako ka shërbyer si gjyqtare e Gjykatës së Lartë prej datës 08.07.2008 deri më datë 07.07.2017.
 - 4) Vendim i trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, datë 29.06.2017.
 - 5) Njoftim për dorëzimin e detyrës nga ana e saj, drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë, datë 31.07.2017.
 - 6) Njoftim i kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, protokolluar me nr. {***}, datë 30.04.2018.
 - 7) Shkresë e Komisionit drejtuar subjektit të rivlerësimit nr. {***} prot., datë 14.05.2018.
 - 8) Kërkesë për pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit drejtuar Komisionit [për dijëni KLD-së dhe ILDKPKI-së], datë 03.12.2018.
 - 9) Shkresë e KLGj-së e datës 03.04.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit lidhur me çështjen e caktimit në një pozicion në nivel apeli.
 - 10) Shkresë e znj. Evelina Qirjako, datë 08.04.2019, drejtuar kryetares së KLGj-së.
 - 11) Shkresë e KLGj-së, datë 30.04.2019, nëpërmjet së cilës i njoftohet znj. Evelina Qirjako vendimi nr. 66, datë 24.04.2019.
 - 12) Vendim i KLGj-së nr. 66, datë 24.04.2019, që ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit.
 - 13) Shkresë e subjektit të rivlerësimit dhe katër ish-anëtarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë, e datës 27.05.2019, drejtuar KLGj-së.
 - 14) Shkresë e KLGj-së, datë 10.06.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe katër ish-anëtarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë [pika 14 më sipër].
 - 15) Relacion i KLGj-së, datë 23.04.2019, “Mbi statusin e magjistratit dhe mbarimin e tij për disa ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë që iu ka mbaruar mandati”.
 - 16) Shkresë e Komisionit, datë 08.07.2019, që përmban njoftimin e vendimit objekt ankimi subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako”.
 - 17) Vendimi i Komisionit objekt ankimi.
 - 18) Njoftime të datave 29.06.2017 dhe 31.07.2017 për median, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

10. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se është subjekti i rivlerësimit që ka depozituar

ankimin brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁴. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumentesh.

11. Trupi gjykues i Kolegjit⁵, në seancën gjyqësore në dhomë këshillimi të zhvilluar më datë 07.12.2020⁶, mori fillimisht në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit që lidheshin me shkeljet e kryera nga Komisioni për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikuj, u konstatua se Komisioni ka dhënë vendim vetëm mbi bazë dokumentesh, pa e ftuar subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me përcaktimet e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, me qëllim dhënien e mundësisë që të dëgjohet në gjykimin e çështjes që i përket asaj⁷.
12. Në vijim të sa më sipër, shqyrtimi i çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit objekt ankimi, u mor në shqyrtim në tri seanca gjyqësore publike, të zhvilluara përkatësisht në datat 23.12.2020, 21.01.2021 dhe 03.02.2021, në prani të subjektit të rivlerësimit. Vendimi i trupit gjykues të Kolegjit u shpall më datë 12.02.2021, në mungesë të subjektit të rivlerësimit⁸.

B. Vlerësimi i kërkesave dhe i provave të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor

13. Më datë 27.11.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, paraqiti kërkesë për pezullimin e procesit të gjykimin të ankimit të paraqitur prej saj kundër vendimit të Komisionit nr. 178, datë 08.07.2019, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes gjyqësore që është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë⁹ dhe gjykimin e kësaj kërkesë në seancë gjyqësore në prani të palëve, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Sipas parashtrimeve në kërkesë, padia e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën Administrative të Apelit lidhet me: i) ligjshmërinë e shkakut ligjor të vendimit të KLGj-së që deklaroi përfundimin e statusit të magjistratit për të [vendimi nr. 66, datë 24.04.2019], si dhe tagrat e KLGj-së në vendimmarrjen konkrete; ii) gjithë procedurën e ndjekur nga KLGj-ja për nxjerrjen e këtij akti, me fokus pjesën e vendimit

⁴ Njoftimi i vendimit të Komisionit, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 08.07.2019, është marrë në dorëzim më datë 09.07.2019. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 22.07.2019.

⁵ Përbërja përfundimtare e trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, është rezultat i shortit të datës 28.07.2020, për zëvendësimin e gjyqtarit Luan Daci (njoftuar subjektit të rivlerësimit më datë 29.07.2020) dhe i shortit të datës 03.12.2020 (shih poshtëshënimin nr. 10).

⁶ <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/11/Shpallje-dhome-keshillimi-subjekti-i-rivleresimit-Evelina-Qirjako.pdf>

⁷ <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Shpallje-SR-Evelina-Qirjako.pdf>

⁸ Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, njoftoi në rrugë elektronike, më datë 11.02.2021, pamundësinë për të qenë e pranishme në seancën për shpalljen e vendimit dhe njëkohësisht lejimin e pjesëmarrjes së një personi tjetër të zgjedhur prej saj. Në seancën gjyqësore të datës 12.02.2021, përpara shpalljes së vendimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se nuk gjendej në kushtet e nenit 96 të K.Pr.Civile, për ta konsideruar personin e caktuar nga subjekti i rivlerësimit si përfaqësues ligjorë të saj në këtë seancë gjyqësore.

⁹ Çështja në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. regjistri {***}, nr. sistemi {***}.

të KLGj-së që referon *heqjen dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli*. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, Kolegji nuk mund të vazhdojë shqyrtimin e ankimit të saj pa u zgjidhur padia e ngritur prej saj në Gjykatën Administrative të Apelit, duke qenë se është në diskutim shkak ligjor që është *gjetur nga KLGj-ja për mbarimin e statusit të magjistrates*. Sipas parashtrimit të subjektit, nëse Gjykata Administrative e Apelit do t'i vlerësojë të drejta pretendimet e saj për pavlefshmërinë e vendimit të KLGj-së, edhe vendimi i Komisionit i cili bazohet në të parin [vendimin e KLGj-së] mbetet i pabazuar. Subjekti kërkoj nga Kolegji që të vendosë pezullimin e gjykimit në Kolegj deri në zgjidhjen e çështjes nga Gjykata Administrative të Apelit, bazuar në nenin 297/a të K.Pr.Civile. Bashkëlidhur kërkesës, subjekti i rivlerësimit paraqiti: 1) vërtetimin nga Gjykata Administrative e Apelit, sipas të cilit çështja që i përket padisë së subjektit të rivlerësimit është regjistruar në gjykatë më datë 05.06.2020; dhe 2) kërkesëpadinë (depozituar në sekretari më datë 03.06.2020), me paditëse A. F. dhe Evelina Qirjako, e paditur KLGj-ja, me objekt shfuqizimin pjesërisht të vendimit nr. 67, datë 24.04.2019 dhe të vendimit nr. 66, datë 24.04.2019, të KLGj-së. Në pjesën fundore të padisë, paditëset shprehen për shfuqizimin e pjesshëm të dy vendimeve të cituara të KLGj-së, sipas formulimit: *Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ [...], duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistrates për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë [...] për shkak të mbarimit të mandatit*.

14. Pas marrjes së njoftimit për zëvendësimin e një prej anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit¹⁰, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë më datë 04.12.2020 për vazhdimin e gjykimit nga trupi gjykues sipas përbërjes së shpallur më datë 12.11.2020, duke parashtruar se sëmundja e përkohshme nuk përbën shkak për zëvendësimin e gjyqtarëve, duke kërkuar shtyrjen e zhvillimit të seancës në një datë tjetër, sipas parashikimeve të legjislacionit dhe referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së. Subjekti argumentoi se ky ndryshim përbën cenim të procesit të rregullt ligjor dhe sigurisë juridike në kontekstin e parimit të gjykatës së krijuar me ligj dhe përbërjes së gjykatës.
15. Në seancën gjyqësore të datës 07.12.2020, pasi u njoh me 2 (dy) kërkesat e subjektit të rivlerësimit të depozituara përkatësisht në datën 27.11.2020 dhe në datën 04.12.2020 (të sipërcituara), trupi gjykues vendosi që kërkesën për pezullimin e çështjes deri në zgjidhjen përfundimtare të padisë që subjekti i rivlerësimit ka ngritur në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas specifikimeve të treguara në kërkesë, ta shqyrtojë në seancë gjyqësore publike. Kërkesa për vazhdimin e gjykimit nga trupi gjykues me përbërjen pas shortit të datës 28.07.2020¹¹, nuk u pranua pasi zëvendësimi i gjyqtarës u bë në zbatim të nenit 181 të K.Pr.Civile¹², i cili parashikon se për shkaqe të përligjura mund të ndodhë zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues mbi bazën e disa kritereve, të cilat u konstatuan të plotësuara në momentin e zëvendësimit. Konkretisht, gjyqtare Natasha Mulaj që ishte njohur me të gjitha aktet e çështjes, deklaroi gatishmërinë për vazhdimin e gjykimit dhe gjykimi i çështjes nuk

¹⁰ Me shortin e datës 03.12.2020, gjyqtare Ina Rama u zëvendësua me gjyqtaren Natasha Mulaj për shkaqe shëndetësore, të diktuar nga protokoll i mjekësor. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë ndryshim më datë 03.12.2020, me shkresë postare dhe në rrugë elektronike.

¹¹ <http://kpa.al/njoftime-7/>.

¹² Neni 181 i K.Pr.Civile parashikon: "Gjykata duhet të organizojë punën që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues. Kur për shkaqe të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari ose anëtarët e rinj duhet të njihen me përmbajtjen e procesit gjyqësor. Anëtari ose anëtarët e rinj mund të kërkojnë që hetimi gjyqësor të përsëritet pjesërisht ose tërësisht. [...]"

kishte filluar ende. Në vijim, shqyrtimi i çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit objekt ankimi, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit me përbërjen e treguar në pjesën hyrëse të vendimit.

16. Në seancën gjyqësore të datës 23.12.2020, subjekti i rivlerësimit parashtrroi fillimisht kërkesën për pezullimin e shqyrtimit të çështjes deri në përfundimin e shqyrtimit të padisë së ngritur në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas argumenteve të paraqitura në kërkesën e datës 27.11.2020.
17. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi t'i kërkojë Gjykatës Administrative të Apelit informacion mbi statusin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe shtyu gjykimin si rrjedhojë. Në zbatim të këtij vendimi dhe të shkresës përkatëse, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë konfirmoi¹³ se çështja që i përket subjektit të rivlerësimit [një ndër paditëset] ishte duke u gjykuar dhe seanca gjyqësore e radhës ishte planifikuar në datën 19.01.2021¹⁴.
18. Në seancën gjyqësore të datës 21.01.2021, subjekti i rivlerësimit informoi Kolegjin që shqyrtimi gjyqësor i çështjes që lidhet me padinë e saj në Gjykatën Administrative të Apelit, kishte përfunduar dhe vendimi ishte caktuar të shpallej në datën 26.01.2021. Subjekti kërkoi shtyrjen e seancës gjyqësore në Kolegji deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Administrative e Apelit¹⁵. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të marrë në cilësinë e provave shkresore shkresën e Gjykatës Administrative të Apelit drejtuar Kolegjit¹⁶ dhe vërtetimin e kësaj të fundit mbi seancën e datës 26.01.2021. Po kështu, trupi gjykues vendosi që mbi bazën e këtyre provave shkresore dhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara, të pranojë kërkesën për shtyrjen e seancës gjyqësore në një datë tjetër, pas datës 26.01.2021. Seanca gjyqësore u caktua më datë 03.02.2021.
19. Në seancën gjyqësore të datës 03.02.2021, subjekti i rivlerësimit i paraqiti trupit gjykues të Kolegjit vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit shpallur më 26.01.2021 [nr. 6], sipas të cilit gjykata kishte vendosur pranimin e padisë dhe ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 66, datë 24.04.2019, të KLGj-së që i përket subjektit të rivlerësimit. Sipas vendimit të shumicës së Gjykatës Administrative të Apelit, statusi i magjistrates për znj. Evelina Qirjako *kishte përfunduar në datën 31.07.2017*. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi po ashtu se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe, në respektim të nenit 451/a të K.Pr.Civile, është i detyrueshëm për të gjitha institucionet dhe gjykatat ku njëra nga palët është pjesëmarrëse. Subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji vazhdimin e shqyrtimit të ankimit të parashtruar prej saj kundër pikës 2 të vendimit të Komisionit. Në seancën e datës 03.02.2021, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të shprehur deklaroi se hiqte dorë nga kërkesa për pezullimin

¹³ Shkresa nr. {***} prot., datë 30.12.2020e Gjykatës Administrative të Apelit, regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 05.01.2021.

¹⁴ Kjo shkresë iu përcoll për dijeni edhe subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, e cila konfirmoi marrjen në rrugë elektronike dhe në seancën gjyqësore të radhës.

¹⁵ Këtë kërkesë subjekti e depozitoi edhe me shkrim, duke argumentuar sërish se ankimi kundër vendimit të Komisionit dhe kërkesëpadia në Gjykatën Administrative të Apelit janë të ndërvarur nga njëri-tjetri. Subjekti depozitoi edhe një vërtetim nga Gjykata Administrative e Apelit, datë 20.01.2021, që konfirmonte seancën e datës 26.01.2021.

¹⁶ Nr. {***} prot., datë 30.12.2020. Cituar edhe në poshtëshënimin nr. 13.

e këtij procesi dhe konsideronte vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit përfundimtar për sa i përket asaj.

20. Subjekti i rivlerësimit parashtroi pretendimet mbi procedurën e kryer dhe vendimin e dhënë nga Komisioni, përfshirë çfarë përbënin shkelje të ligjit procedural e cenim të procesit të rregullt ligjor, sipas subjektit, si dhe themelit të ankimit të saj. Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit u shpreh se statusi i magjistrates për të ka përfunduar bashkë me mandatin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, kur ka dorëzuar detyrën më datë 31.07.2017, sikurse është shprehur edhe Gjykata Administrative e Apelit. Në kushtet kur kjo gjykatë ka shfuqizuar atë pjesë të vendimit të KLGj-së që përcakton shkakun ligjor dhe afatin për përfundimin e statusit të magjistrates, pasojat ligjore bëhen *nul* nga momenti i nxjerrjes së aktit dhe efektet e tij shuhen. Në këto kushte, duke mos ekzistuar akti, nuk ekziston as shkak ligjor që i ka shërbyer Komisionit për të marrë pikën 2 të vendimit, ndërsa pjesa e parë e vendimit qëndron duke qenë se subjekti nuk ishte më magjistrate.

20.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe kronologjia kohore e referuar nga Komisioni për mbarimin e statusit të magjistratit, nuk qëndron në kushtet kur sipas Gjykatës Administrative të Apelit, data e mbarimit ka qenë 31.07.2017. Subjekti i rivlerësimit argumentoi se mbarimi i statusit ka ndodhur natyralisht, pra nuk ka më heqje dorë nga detyra dhe as heqje dorë nga statusi. Po kështu, procesi i rivlerësimit ka nisur në mars dhe vendimi është dhënë në korrik 2019, kohë kur subjekti nuk ka qenë në detyrë. Statusi i kishte përfunduar natyralisht, e për rrjedhojë nuk ishte më subjekt i ligjit nr. 84/2016. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekte rivlerësi janë gjyqtarët në detyrë ose ata që gëzojnë titullin magjistrat. Me mbarimin e detyrës, pretendon subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ajo nuk ishte më subjekt i ligjit pasi nuk gëzonte titullin magjistrate për shkaqe të natyrshme që më datë 31.07.2017. Ky element nënkupton, sipas subjektit të rivlerësimit, se Komisioni doli jashtë tagrave, duke përfshirë në proces edhe subjekte që nuk ishin më në rrethin që ligji përcakton. Subjekti i rivlerësimit shprehet se parashikimet e nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 – që rregullojnë dorëheqjen – dhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 78/2017 (paragrafi 43), nuk janë relevante në çështjen e saj, pasi ajo nuk ka qenë në detyrë për shkak të mbarimit të mandatit sipas ligjit. Konkluzioni në vendimin e Komisionit që, sipas subjektit, përbën një deduksion, tashmë nuk qëndron. Po ashtu, subjekti argumentoi që refuzimi i saj për të mos u emëruar në një gjykatë apeli përbën një mosushtrim të drejte për të cilën ajo është penalizuar.

20.2. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji që të vendosë prishjen e pikës 2 të vendimit të Komisionit objekt ankimi, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në argumentet se: i) pjesa e aktit administrativ të KLGj-së mbi të cilën është bazuar Komisioni për të vendosur penaltetin në pikën 2 të vendimit të tij, është shfuqizuar me vendim të formës së prerë e, si rrjedhojë, nuk ekziston; ii) nuk është vërtetuar heqja dorë në mënyrë të vullnetshme nga detyra apo nga statusi për të, kushte të pretenduara nga Komisioni për të aplikuar nenin G të Kushtetutës; dhe iii) u vërtetua që në momentin e nisjes së procesit të rivlerësimit dhe marrjes së vendimit nga Komisioni, subjekti nuk ishte më gjyqtare, nuk gëzonte titullin e magjistrates e, për rrjedhojë, nuk ishte më subjekt i ligjit nr. 84/2016 dhe i nenit 179/b, pika e 3 e Kushtetutës.

21. Subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet përfundimtare mbi shkaqet e ankimit edhe në formë të shkruar – titulluar “Notë verbale” – si dhe vendimin nr. 6, datë 26.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku trupi gjykues [me shumicë votash] ka vendosur pranimin e padisë së subjektit të rivlerësimit dhe ndryshimin e pjesshëm të vendimit të KLGj-së nr. 66, datë 24.04.2019, duke deklaruar *mbarimin e mandatit të magistrates* për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë znj. Evelina Qirjako, në datën 31.07.2017.
22. Gjatë seancës gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të marrë në cilësinë e provës vendimin nr. 6, datë 26.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Trupi gjykues vendosi të vazhdojë shqyrtimin e çështjes dhe ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, të paraqiste pretendimet e saj. Në përfundim të seancës gjyqësore, pasi subjekti i rivlerësimit konfirmoi se nuk kishte asnjë provë që do të donte të merrej në këtë gjykim dhe se nuk kishte asnjë pretendim shtesë, trupi gjykues i Kolegjit mbylli debatin gjyqësor në seancë gjyqësore publike lidhur me ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit kërkoi përfundimisht prishjen e pikës 2 të vendimit të Komisionit nr. 178, datë 08.07.2019, për të gjitha arsyet e parashtruara në gjykim. Subjekti solli në vëmendje se ankimi i saj konteston vetëm pikën 2 të vendimit objekt ankimi – ndalimin 15-vjeçar të parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

C. *Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me shkelje të parimeve procedurale*

23. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se veprimtaria e Komisionit nuk bazohet në parimet kushtetuese e ligjore që garantojnë transparencën, informimin, objektivitetin, drejtësinë dhe paañësinë, komunikimin me palët, si dhe ushtrimin e së drejtës për t’u njohur me materialet e dosjes, së drejtës për të paraqitur mendime dhe shpjegime në lidhje me çështjen, së drejtës për të bashkëpunuar gjatë hetimit administrativ, së drejtës për të kërkuar prova dhe dokumente të tjera, së drejtës për të paraqitur prova dhe informacione, së drejtës për t’u dëgjuar për provat e paraqitura në çdo formë të përshtatshme, qoftë me shkrim apo me gojë. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, Komisioni ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, pasi ajo nuk është pyetur apo dëgjuar asnjëherë nga Komisioni për pikën 2 të dispozitivit të vendimit, i cili sjell pasoja të drejtpërdrejta dhe serioze ndaj saj. Për rrjedhojë, procedura duhet të ishte e përpiktë, rigoroze dhe pa të meta. Subjekti argumenton se Komisioni e ka marrë vendimin duke vepruar kryesisht me iniciativën e tij, duke luajtur njëkohësisht edhe rolin e organit administrativ, edhe atë vendimmarrës dhe duke e *penalizuar në kundërshtim me ligjin*. Argumentet ligjore për këtë pretendim subjekti i rivlerësimit i mbështet në jurisprudencën e GJEDNj-së dhe të Gjykatës Kushtetuese.
24. Lidhur me këtë pretendim, nga dokumentacioni i administruar në fashikuj, trupi gjykues konstaton se Komisioni dhe subjekti i rivlerësimit kanë shkëmbyer korrespondencë me shkrim përkatësisht në datat 30.04.2018 dhe 14.05.2018. Në përgjigje të njoftimit nga subjekti se ajo ka humbur statusin për shkak të ligjit dhe si pasojë nuk është më subjekt rivlerësimi, Komisioni ka potencuar cilësinë si subjekt rivlerësimi për shkak të përcaktimit ligjor dhe kushtetues dhe faktit që, me hyrjen në fuqi të ligjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ishte gjyqtare në Gjykatën e Lartë dhe ka analizuar pasojat e nenit G të Kushtetutës. Më tej, pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, të datës 03.12.2018,

Komisioni ka vijuar komunikimin me KLGj-në. Me shkresën e datës 23.01.2019¹⁷, Komisioni ka kërkuar nga KLGj-ja vlerësimin dhe qëndrimin mbi procedurat për statusin e magjistratit për ish-anëtarët e Gjykatës së Lartë. Më tej, KLGj-ja ka komunikuar me subjektin e rivlerësimit fillimisht për të konfirmuar realizimin e së drejtës për t'u caktuar në një pozicion në nivel gjykatë apeli, dhe më pas për vënien në dijeni të vendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga kjo e drejtë.

25. Në të njëjtën kohë, si është shtjelluar më sipër në paragrafin 11 të këtij vendimi, Komisioni nuk i mundësoi subjektit të rivlerësimit pjesëmarrjen në një proces publik në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, nenit 42 dhe 179/b të Kushtetutës, të shtjelluar edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe në opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka gëzuar garancitë procedurale që i ofrojnë mundësinë për të paraqitur shpjegime me shkrim dhe me gojë gjatë procesit gjyqësor, dhënien e kohës së nevojshme për të paraqitur prova dhe dokumente, për të përgatitur kundërgargumentet dhe prapësimet e nevojshme gjatë procesit dhe dhënien e mundësisë për njohjen me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.
26. Megenëse aplikimi i parashikimit të nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për ndalimin e ushtrimit të funksioneve të caktuara për një periudhë prej 15-vitesh përbën pasojën më të rëndë të procesit të rivlerësimit, Komisioni do të duhej të dëgjonte subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, dhe t'i mundësonte paraqitjen shteruese të argumenteve nga ana e saj për një proces të rregullt ligjor. Po ashtu, nuk rezulton që Komisioni të jetë gjendur në një nga rastet përjashtimore të parashikuara nga neni 89 i K.Pr.Administrative¹⁸, që legjitimon përjashtimin nga e drejta e subjektit për t'u dëgjuar. Përpos kësaj, Komisioni duhej të mbështetej në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Kushtetuese, praktikën e gjerë të GjEDNj-së, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit¹⁹ që thekson rëndësinë e respektimit të parimeve procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.
27. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, duke e vlerësuar të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, bazuar në nenin 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012, vendosi të ndreqë këtë të metë procedurale të procesit dhe të dëgjojë subjektin e rivlerësimit në seancë gjyqësore publike, për t'i garantuar të drejtën për t'u dëgjuar nga një trupë gjykuese e paanshme dhe e krijuar sipas parashikimeve të ligjit.

Ç. *Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me themelin e çështjes – pika 2 e vendimit objekt ankimi*

28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është konfuz, i marrë në bazë të provave dhe fakteve që nuk ekzistojnë, në mungesë të plotë të analizës logjike dhe juridike, si

¹⁷ Nr. {***} prot.

¹⁸ Neni 89 i K.Pr.Administrative, parashikon: "[...] Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme: a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonesës interesit publik; b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative; c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës; ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur d) është parashikuar shprehimisht me ligj".

¹⁹ Shih vendimet që u përkasin subjekteve të rivlerësimit Adriatik Llalla [nr. 1/2018 (JR), datë 11.06.2018], Mirela Fana [nr. 5/2018 (JR), datë 10.09.2018] etj.

dhe pasojë konkluzionesh të pabazuara në ligj. Lidhur me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në materialin “Notë verbale”, të paraqitur në seancën gjyqësore të datës 03.02.2021, analizon vendimin e Komisionit [paragrafët 30, 25, 28 dhe 42], duke shtruar për argument tri çështje që lidhen me i) interpretimin e Kushtetutës dhe të kuadrit ligjor që parashikon ushtrimin e funksionit të anëtarit të Gjykatës së Lartë përtej kohëzgjatjes kushtetuese të mandatit, ii) raportin e kohëzgjatjes dhe mbarimit të mandatit me kohëzgjatjen e statusit të magjistratit, dhe iii) aplikimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës në kushtet e mbarimit të statusit për shkak të ligjit dhe jo për shkak të dorëheqjes së vullnetshme dhe penalizimit për shkak të mosushtrimit të një të drejte të dhënë me ligj²⁰.

29. Komisioni ka vlerësuar se, me përfundimin e mandatit si anëtare e Gjykatës së Lartë, znj. Evelina Qirjako ka gëzuar të drejtën që të ishte ende pjesë e sistemit të drejtësisë si gjyqtare në nivel gjykate apeli. Për këtë arsye, Komisioni ka konkluduar se deri në momentin e shfaqjes së vullnetit të saj dhe të nxjerrjes së vendimit nga KLGj-ja për përfundimin e statusit të magjistrates për ish-gjyqtaren, kjo e fundit ka qenë subjekt rivlerësimi²¹. Më tej, Komisioni arsyeton se, me refuzimin e së drejtës për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, *me shfaqjen e vullnetit të saj se heq dorë nga kjo e drejtë edhe në të ardhmen*, që passjell dhe mbarimin e statusit të magjistrates, znj. Evelina Qirjako ka konsumuar në mënyrë indirekte aktin e dorëheqjes dhe ky akt është paraqitur në një prej institucioneve të caktuara me ligj në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Për këto arsye, në vlerësimin e Komisionit, vullneti i subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqje është i pavesuar dhe subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Sipas Komisionit, ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, zbatimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës që dikton humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
30. Nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit dhe ato të administruara në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, rezulton se më datë 29.06.2017, trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit [9-vjeçar] të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë²², për subjektin e rivlerësimit, mbështetur në nenin 139, pika 2 e Kushtetutës. Më 31.07.2017, subjekti ka dorëzuar detyrën nëpërmjet shkresës së dërguar për këtë qëllim kryetarit të Gjykatës së Lartë. Këto dy fakte i janë njoftuar po në të njëjtën ditë Presidentit të Republikës nga kryetari i Gjykatës së Lartë. Në shkresën njoftuese, referohet mbarimi i mandatit dhe dorëzimi i detyrës nga pesë (5) gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, mandati i të cilëve mbaronte formalisht më datë 28.07.2017. Më 11.01.2018, rezulton që subjekti i rivlerësimit është regjistruar si person fizik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”), në fushën e veprimtarisë *shërbime, konsulencë, ekspertizë ligjore, avokat*.

²⁰ Në materialin “Notë verbale”, të paraqitur në seancën gjyqësore të datës 03.02.2021, subjekti ka shtuar edhe dy pyetje: “[...] C. Në kushtet që statusi im si magjistrate përfundoi për shkak të ligjit (mbarimi i mandatit), a jemi përpara heqjes dorë në mënyrë të vullnetshme nga ushtrimi detyrës? [...] A ekziston në ligj termi heqje dorë në mënyrë indirekte nga detyra dhe për rrjedhojë edhe sanksionet për këtë qëllim? [...]”. (faqe 17).

²¹ Paragrafi nr. 28, vendimi objekt ankimi i Komisionit.

²² Emëruar me dekret të Presidentit të Republikës nr. 5793, më datë 08.07.2008.

31. Më datë 30.4.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ka informuar Komisionin që nuk ka kërkuar të emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit dhe se ka filluar ushtrimin e profesionit të avokates. Subjekti i rivlerësimit ka specifikuar në atë shkresë edhe që statusi i saj si gjyqtare ka mbaruar për shkak të ligjit dhe nuk është më subjekt i ligjit nr. 84/2016, në zbatim të neneve 3, pika 16 dhe 58 të ligjit nr. 84/2016.
32. Siç është referuar edhe në paragrafin 24, më datë 14.05.2018²³, në përgjigjen e dërguar, Komisioni ka theksuar të drejtën e subjektit që të vazhdojë të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë [si gjyqtare në gjykatën e apelit] dhe pasojat e ndërprerjes së rivlerësimit nga ana e Komisionit. Më datë 03.12.2018, më shumë se gjashtë muaj më pas, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për pushimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, drejtuar Komisionit [për dijeni Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave], duke risjellë *përsëri* në vëmendje se, duke mos ushtruar detyrën, ajo nuk është më subjekt rivlerësi sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës e, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka më objekt për procedimin administrativ, parashikuar në nenin 95 të K. Pr. Administrative.
33. Në vijim të shkresës së datës 23.01.2019 të Komisionit, që kërkonte vlerësim të statusit të magjistratit për pesë ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, më datë 03.04.2019, KLGj-ja ka informuar subjektin e rivlerësimit për pozicionet e lira në 3 (tri) gjykata apeli [Tiranë, Durrës dhe Vlorë] duke kërkuar njëkohësisht edhe konfirmim për të drejtën e caktimit në një pozicion në nivel apeli. Në shkresë, KLGj-ja informon se qëndrimi i subjektit do të përbëjë baza për të konsideruar vazhdimin më tej të statusit të magjistratit. Në përgjigjen e datës 08.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka rikonfirmuar²⁴ për KLGj-në mungesën e interesit për t'u emëruar në gjykatat e apelit në kohën në fjalë dhe të ardhmen, duke sjellë në vëmendje edhe faktin e angazhimit të saj në ushtrimin e aktivitetit privat.
34. Më datë 25.4.2019, Komisioni është njohur me vendimin e KLGj-së nr. 66, datë 24.04.2019, për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistrates për znj. Evelina Qirjako, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivelin e gjyqtarës së apelit. Më datë 03.06.2020, 14 muaj pas vendimit të mësipërm të KLGJ-së, dhe 11 muaj pasi Komisioni mori vendimin objekt ankimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kërkesë padi për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të KLGj-së në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Më datë 26.01.2021, Gjykata Administrative e Apelit vendosi të pranojë padinë e paditëses Evelina Qirjako, duke ndryshuar pjesërisht vendimin e KLGj-së që i përket znj. Evelina Qirjako, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistrates për të në datën 31.07.2017.
35. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të trajtojë pretendimet në ankim që janë pjesë e juridiksionit rishikues të Kolegjit në procesin e rivlerësimit. Në këtë analizë, abstragohet nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit që lidhen ekskluzivisht me çështje që lidhen me emërimin, qëndrimin në detyrë, kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, në zbatim të Kushtetutës dhe të kuadrit ligjor sipas parashikimeve

²³ Shkresa nr. {***} prot. – nënshkruar nga kryetarja, znj. Genta Tafa (Bungo).

²⁴ Referuar shkresave të mëparshme tekstualisht në letër, ku subjekti shprehet se ka konfirmuar të njëjtin qëndrim më 30.04.2018 dhe më datë 03.12.2018, në shkresat për dijeni edhe të KLD-së, KPK-së dhe ILDKPKI-së.

përpara dhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe me ligje të tjera të paketës së reformës në drejtësi – sikurse ligji që rregullon statusin e magjistratëve apo ligji që rregullon organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë²⁵. Për këto arsye, analiza që vijon fokusohet në pretendimet dhe argumentet e subjektit të rivlerësimit që lidhen me zbatimin nga Komisioni të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, që përbën pretendimin themelor të ngritur në ankim dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj.

36. Pretendimet dhe argumentet e subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, fokusohen kryesisht rreth dy çështjeve kryesore: a) nëse subjekti i rivlerësimit mund të vazhdonte ushtrimin e detyrës në cilësinë e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë edhe pas përfundimit të mandatit kushtetues sipas parashikimeve të ligjit nr. 76/2016; dhe b) përcaktimi i momentit fillestar e fundor të statusit të magjistrates në rastin e saj [në cilësinë e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë]. Pjesë e analizës së pyetjes së dytë është edhe pyetja nëse statusi i magjistrates për subjektin e rivlerësimit përfundonte për efekt të ligjit, me mbarimin e mandatit kushtetues 9-vjeçar.

36.1. Trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje, së pari, se interpretimi i kuadrit ligjor është kompetencë e institucioneve që i zbatojnë këto parashikime ligjore. Në rastin konkret, kuadri ligjor që përbën procesin e rivlerësimit, është kompetencë e Komisionit dhe e Kolegjit. Po ashtu, kuadri ligjor që rregullon statusin e magjistratëve, është kompetencë e KLGj-së apo KLP-së, sipas rastit. Në vijim të këtij parimi, është e natyrshme që për pyetje dhe procedura që lidhen me statusin e subjekteve të rivlerësimit, Komisioni apo Kolegji kanë nevojë për opinionin e secilit prej këtyre dy institucioneve. Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje edhe me jurisprudencën²⁶ e Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur:

[...] Interpretimi i ligjeve është para së gjithash e drejta për çdo organ që i zbaton ato. [...] dhe [...] Interpretimi, si funksion dhe metodë, ka vend për një normë ekzistuese kur ka paqartësi në kuptimin e saj dhe jo për të plotësuar boshllëkun, sepse përndryshe Gjykata Kushtetuese do të vihej në pozicionin e gabuar të krijesit të normës juridike, funksion që, siç dihet, i përket ligjvënësit. [...]

36.2. Në kontekst të sa më sipër, është me rëndësi të veçantë të theksohet se qëndrimi i trupit gjykues të Kolegjit mban në konsideratë faktin që pretendimet e subjektit që lidhen me shkakun dhe kohën e mbarimit të statusit të magjistratit për të, të parashtruara edhe në Kolegj, iu nënshtruan shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga KLGj-ja – në zbatim direkt nga Komisioni edhe të jurisprudencës orientuese të Kolegjit²⁷ – duke vijuar me një gjykatë, pjesë e pushtetit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, që lidhen me kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës si anëtare e Gjykatës së Lartë apo me kohëzgjatjen e statusit të magjistrates, konsiderohen jorelevante për sa i përket procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, nën dritën dhe në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10²⁸. Në kushtet kur ndryshimet kushtetuese që normuan rivlerësimin e gjetën subjektin

²⁵Ligji nr. 96/2016 dhe ligji nr. 115/2016.

²⁶ Shih vendimin nr. 24, datë 13.02.2002, paragrafi 2 (fjalja e pestë) dhe vendimin nr. 75, datë 19.04.2002, paragrafi i dytë, faqe 7.

²⁷ Referuar, ndër të tjera, edhe në poshtëshënimin nr. 19.

²⁸ Dispozitat e këtyre pikave parashikojnë si vijon: “1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. [...] 3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë [...], i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. [...] 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i

e rivlerësimit në një nga detyrat e përmendura nominalisht nga pika 3 e kësaj dispozite, ajo ishte subjekt rivlerësimi *ex-officio*. Ky fakt qëndron, është i pakontestueshëm dhe autonom nga momenti kur statusi i magistratit *deklarohet* i mbaruar nga institucionet përkatëse.

36.3. Për të njëjtën arsye, nuk është i bazuar dhe as logjikisht i pranueshëm këndvështrimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, sipas të cilit, në kuptim të nenit 179/b, ajo e cilëson veten ish-gjyqtare dhe, si rrjedhojë, do t'i nënshtrohej rivlerësimit vetëm me kërkesë²⁹. Ky qëndrim është në përputhje edhe me jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit, lidhur me një subjekt rivlerësimi që pretendoi të ishte ish-subjekt³⁰. Qartazi, në momentin kur u miratuan dhe hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese që përfshinë edhe këtë dispozitë – korrik dhe gusht 2016 respektivisht – subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ishte gjyqtare. Nëse do të pranohej argumenti i saj, nga procesi i rivlerësimit do të përjashtoheshin me sukses të gjithë subjektet që nuk ishin në detyrë në momentin kur u vinte radha të shortheshin apo çështja e tyre të shqyrtohej nga Komisioni, gjatë gjithë harkut kohor prej 5 vjetësh që përbën mandatin e këtij të fundit, megjithëse e gëzonin këtë cilësi me hyrjen në fuqi të ligjit. Kësisoj, procesi i rivlerësimit do të përfshinte subjektet mbi baza tejet rastësore, të kushtëzuara thjesht nga shorti i Komisionit dhe përfundimi ose jo i rivlerësimit deri në momentin në kohë kur për një arsye të caktuar, nuk kryenin më detyrën që i kishte cilësuar si subjekte rivlerësimi. Asgjë në frymën apo gjuhën e normave kushtetuese e ligjore nuk mbështet këtë këndvështrim selektiv të parashtruar nga subjekti, përkundrazi. Për nga natyra gjithëpërfshirëse, procesi i rivlerësimit në mënyrë specifike është parashikuar nga kushtetutëbërësi të përfshijë së pari dhe shprehimisht magistratët/subjektet e rivlerësimit që, si subjekti, shërbenin në majat më të larta të drejtësisë shqiptare, por edhe këshilltarët ligjorë apo inspektorët e KLD-së jomagjistratë.

36.4. Në përmbledhje të sa më sipër, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk afekton faktin e pakontestueshëm se znj. Evelina Qirjako, në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese që parashikuan procesin e rivlerësimit, ushtronte detyrën e anëtares së Gjykatës së Lartë e, për rrjedhojë, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, u përfshi automatikisht në kategorinë e subjekteve që do t'i nënshtroheshin këtij procesi *ex officio*. Mandati i gjyqtares së Gjykatës së Lartë, për subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, u deklarua i mbaruar në muajin qershor 2017, ndërsa dorëzimi i detyrës u krye në korrik 2017, pra rreth 11 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese (11.08.2016), rreth 7 muaj pas fillimit të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 (19.01.2017). Në leximin literal të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, duke abstraguuar nga vonesat e ndodhura në zbatimin e tij, subjekti i rivlerësimit do t'i ishte

Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje. [...] 7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit. [...] 10. Procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit dhe ligjit.”

²⁹ Pika 4 e nenit 179/b parashikon: “[...] Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. [...]”

³⁰ Shih vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo) [nr. 17, datë 25.07.2019], paragrafi 21.5: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-V-Bala-i-ANONIMIZUAR.pdf>, që pasqyron edhe qëndrimin e vëzhguesit ndërkombëtar.

nënshtuar procesit të rivlerësimit përpara mbarimit të mandatit, meqenëse rivlerësimi i saj do të trajtohej me *përparësi në kohë*, sikurse përcakton neni 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Përpos kësaj, Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, në asnjë rresht nuk diferencen në trajtimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë duke u nisur nga premisa e kohëzgjatjes së mandatit të tyre³¹. Legjislatori prezumohet të ketë qenë i informuar qartë me mandatet kushtetuese të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, duke qenë se qëllimi i procesit është *rivlerësimi kalimtar i të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi*, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, bazuar mbi argumentin kohor të *dorëzimit të detyrës* nga ana e saj, bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjin.

36.5. Përveç sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë mbështetje as në ecurinë e deritanishme të procesit të rivlerësimit, të cilit i janë nënshtuar të gjithë anëtarët e Gjykatës së Lartë, në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, pa marrë në konsideratë kohën e mbarimit të mandatit të secilit prej tyre. Një pjesë e anëtarëve janë konfirmuar apo shkarkuar nga detyra me vendim të formës së prerë, ndërsa për një pjesë tjetër është ndërprerë procesi për shkak të heqjes dorë nga detyra apo heqjes dorë nga statusi i magjistratit. Ndër ta, trupa gjyquese të ndryshme të Kolegjit kanë marrë vendime për ankime me pretendime identike – për shfuqizime të pjesshme të pikës 2 të vendimeve respektive të Komisionit, për shkak se nuk janë shprehur për dorëheqje tekstualisht – për dy subjekte, të cilat kanë dorëzuar detyrën në rrethana identike dhe në të njëjtën ditë me subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, formalizuar në të njëjtën ditë dhe shpallur për publikun bashkërisht nga Gjykata e Lartë në faqen zyrtare³² në të njëjtin grupim për shkak të mbarimit të mandatit 9-vjeçar. Në të dyja rastet e shqyrtuara më parë³³, trupat gjyquese të Kolegjit kanë konkluduar pakontestueshmërinë e faktit që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e ligjore që sollën rivlerësimin, ishin subjekte rivlerësimi *ex-officio* dhe mungesa e interesit për të vijuar më tej të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë, interpretuar në kontekstin e vullnetit të pavesuar nga ana e tyre në funksion të ndërprerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni, është lënë në fuqi edhe në Kolegj.

36.6. Në çfarëdo konteksti ligjor apo faktik, pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë mbështetje në qëllimin e legjislatorit që anëtarët e Gjykatës së Lartë t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit me *përparësi në kohë*. Legjislacioni që normon procesin e rivlerësimit parashikon

³¹ Konkretisht, nga informacioni që rezulton nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, mandatet e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e ligjore që sollën procesin e rivlerësimit, sipas një përlllogaritjeje të thjeshtë dhe të kushtëzuar nga niveli i detajeve në këtë burim, variojnë si vijon: gjyqtarës Mirela Fanës do të duhet t'i mbaronte mandati në vitin 2018, gjyqtarëve Edmond Islami dhe Shkëlzen Selimi më 28.06.2020, Xhezair Zaganjorit më 24.04.2022, Ardian Dvoranit i kishte mbaruar më 2014, Andi Çelikut më 2017, Medi Bicit më 2019, Artan Brocit më 2.05.2022, Admir Thanzës e Tom Ndrecës më 29.04.2022 dhe Artan Zenelit më 12.09.2021.

³² Shih respektivisht njoftimet e Gjykatës së Lartë në faqen zyrtare, respektivisht në datat 29.06.2017, 04.07.2017 dhe 31.07.2017:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Ne_lidhje_me_deklarimin_e_perfundimit_te_mandateve_te_disa_gjyqtarev_e_te_gjykates_se_Larte_informojme_publicun_si_me_poshte_se_4574_1.php

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftim_per_dorezimin_e_detyres_4623_1.php, dhe:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Ne_lidhje_me_deklarimin_e_perfundimit_te_mandateve_te_disa_gjyqtarev_e_te_gjykates_se_Larte_informojme_publicun_si_me_poshte_se_4574_1.php

³³ Vendimi i Kolegjit nr. 38/2020 që lidhet me subjektin e rivlerësimit Aleksandër Muskaj dhe vendimin nr. 30/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani.

qartësisht se institucionet e rivlerësimit duhet të rivlerësojnë subjektet e përcaktuara shprehimisht në pikat 3 të nenit 179/b të Kushtetutës. Në rast se këto subjekte vendosin të mos i nënshtrohen këtij procesi, atëherë ata përjashtohen nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Parashikimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës është shterues. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit shoqërohet pashmangshmërisht me ndalimin ligjor për t'u emëruar në pozicione specifike për 15 vjet. Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë që, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, kanë fituar statusin *subjekt rivlerësimi*, pa bërë dallime ndërmjet tyre, qoftë kjo edhe për shkak të kohëzgjatjes së kufizuar të ushtrimit të detyrës. Në raport me procesin e rivlerësimit, të gjitha këto subjekte konsiderohen të barabarta. Ky vlerësim mbështetet edhe në qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj kur ka kryer kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 56 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me parashikimin e institutit të dorëheqjes³⁴.

36.7. Duke u kthyer në rrethanat faktike të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ka humbur statusin e magjistrates dhe ka shprehur vullnetin e saj të pavesuar për të mos iu nënshtrouar procesit të rivlerësimit, duke shprehur dakordësinë për pikën 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit që përcaktonte *ndërprerjen* e procesit të rivlerësimit. Vullneti i saj për ndërprerjen/pushimin e procesit të rivlerësimit është konfirmuar në korrespondencën me Komisionin, KLGj-në, në ankim, si dhe në parashkrimin e pretendimeve të paraqitura gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji. Përpos kësaj, në mbështetje të legjislacionit të zbatueshëm dhe të jurisprudencës së tij të konsoliduar tashmë, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se mbarimi i statusit të magjistratit pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, pavarësisht datës kur ky fakt ka ndodhur, shkakton humbjen e kësaj cilësie të domosdoshme për të vijuar procesin e rivlerësimit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016³⁵.

36.8. Përveç sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara gjatë procesit dhe qëndrimit të shprehur të subjektit të rivlerësimit, se: [...] *nuk dëshiroj të aplikoj dhe emërohem si gjyqtare në nivel apeli as tani dhe as në të ardhmen.* [...], në zbatim edhe të parashikimit të nenit 45, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit konstaton situatën subjektive nëpërmjet vullnetit të shprehur me shkrim si heqje dorë nga e drejta për të ushtruar detyrën e gjyqtares në nivel gjykate apeli, në përputhje me nenin G, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Nga korrespondenca e subjektit të rivlerësimit me Komisionin (datë 30.04.2018), konstatohet se vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako ishte e qartë që gëzonte të drejtën për t'u emëruar në gjykatë apeli, duke u shprehur se *nuk kam paraqitur asnjë kërkesë për t'u emëruar në Gjykatë Apeli*. Në korrespondencën me KLGj-në (datë 08.04.2019), subjekti i rivlerësimit i është referuar mungesës së dëshirës/vullnetit për të shërbyer në një ndër tri gjykatat e sugjeruara, ndërsa mbarimi i mandatit nuk rezulton të ketë përbërë bazë apo referencë për qëndrimin e saj. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se në një analizë të të gjitha rrethanave faktike dhe dispozitave ligjore që lidhen me procesin e rivlerësimit dhe statusin e

³⁴Paragrafi 43 i vendimit nr. 78/2017: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

³⁵Shih ndër të tjera vendimet e Kolegjit: nr. 38/2020 që lidhet me subjektin e rivlerësimit Aleksandër Muskaj, nr. 30/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Arjana Fullani dhe nr. 18/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Sinjari.

magjistratit, në kushtet kur: a) subjekti kërkon ndërprerjen e procesit të rivlerësimit; dhe b) vullneti për të mos qenë pjesë e drejtësisë është i pavesuar, në frymën e ligjit nr. 96/2016 subjekti ka hequr dorë nga detyra, ndërsa në frymën e ligjit nr. 84/2016 gjendemi në rrethanat e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit. Si pasojë, gjen zbatim, si edhe në rastet e sipërcituara nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit, ndalimi prej 15 vjetësh, i parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i KLGj-së ose i KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm.

36.9. Argumentet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave vijimi i detyrës së saj përtej mandatit si anëtare e Gjykatës së Lartë do të ishte në mospërputhje me ligjin, janë në funksion të pretendimit se ajo nuk ishte subjekt i ligjit të rivlerësimit dhe, për pasojë, procesi i rivlerësimit ndërpritet për shkak se objekti i tij ishte bërë i pamundur. Duke abstraguar nga pabazueshmëria e këtyre pretendimeve në ligj³⁶ dhe rrethanat faktike, trupi gjykues i Kolegjit vëren, sikurse është shtjelluar më sipër në paragrafin 36.8, se vullneti i shprehur nga subjekti për të mos vijuar më tej detyrën e magjistrates, si dhe kërkesa e shprehur me shkrim për ndërprerje të procesit të rivlerësimit, me të drejtë u konsiderua nga Komisioni si heqje dorë nga detyra.

37. Subjekti i rivlerësimit pretendon se referimi në njoftimin e bërë për publikun në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë lidhur me deklarinimin e mbarimit të mandatit, është i pavërtetë pasi nuk ekziston dhe, për më tepër, kjo shprehje në këtë lloj formati nuk ka vlerë ligjore pasi nuk përbën burim të jurisprudencës. Trupi gjykues i Kolegjit, siç edhe është referuar më sipër në arsyetimin në paragrafin 36.5, vëren se nga aksesimi i faqes elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezultojnë 3 (tri) publikime për median dhe për publikun, lidhur me çështjen e mbarimit të mandatit të një pjese të gjyqtarëve në vitin 2017³⁷, konkretisht publikimet e datës 29.06.2017; të datës 04.07.2017 dhe të datës 31.07.2017. Për sa rezulton nga aksesimi në këtë faqe, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni i është referuar një lajmi të pavërtetë, është i pabazuar në fakte. Mbarimi i mandatit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në vitin 2017 dhe veprimet e ndërmarra nga trupa gjyqësore dhe kryetari i Gjykatës së Lartë janë bërë publike duke siguruar në këtë mënyrë transparencën e veprimitarisë së këtij institucioni. Nga leximi i vendimit të Komisionit, konstatohet se pasqyrimi i të dhënave nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë ka përbërë një verifikim të kryer në burime të hapura dhe të aksesueshme për publikun në funksion të hetimit administrativ. Ndonëse nuk përbën burim të jurisprudencës, njoftimet zyrtare të institucioneve, në zbatim të përgjegjësive të tyre ligjore për informim dhe transparencë, kanë peshë në autenticitetin e informacionit dhe krijimin e një raporti të shëndetshëm mes institucioneve publike me qytetarët taksapagues dhe kanë efikasitet të

³⁶ Neni 136, pika 5 e Kushtetutës parashikon "[...] 5. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët 'c', 'ç', 'd' dhe 'dh'." Mbarimi i mandatit 9-vjeçar, nënparagrafi "b" shprehimisht nuk përbën një nga përjashtimet e parashikuara. Dispozita kalimtare së cilës subjekti i referohet, neni 179, pika 4 e Kushtetutës me ndryshimet e vitit 2016, që kushtëzon qëndrimin me afatin e mandatit të mëparshëm, qartazi i referohet situatës së mandateve me afate të ndryshme të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, përmendur në poshtëshënimin nr. 31, që tregon një gamë të gjerë mandatesh me data mbarimi nga viti 2014 deri në vitin 2022. Të njëjtin qëndrim duket të kenë parashtruar edhe njoftimet zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 04.07.2017:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Ne_lidhje_me_deklarimin_e_perfundimit_te_mandateve_te_disa_gjyqtarev_e_te_gjykates_se_larte_informojme_publicun_si_me_poshte_se_4574_1.php, dhe njoftimi i datës 31.07.2017: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftim_per_dorezimin_e_detyres_4623_1.php, referuar edhe më sipër.

³⁷ Shih poshtëshënimin nr. 32 më sipër.

paprecedentë në ndarjen e informacionit me rëndësi në një shoqëri demokratike që vlerëson transparencën dhe llogaridhënien. Si të tilla, njoftimet kanë shërbejnë për të informuar publikun edhe mbi situatën që lidhet me ushtrimin e detyrës së anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjithsesi, ky konstatim nuk ndikon vlerësimin në tërësi që Komisioni ka kryer lidhur me ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit të subjektit.

38. Subjekti pretendon se Komisioni ka paragjykuar çështjen për shkak të referimit në shkresa dhe korrespondencë përpara se të hidhej shorti për caktimin e trupit gjykues dhe ka arritur në përfundime përpara se të shprehej KLGj-ja. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se shkresa e Komisionit, dërguar subjektit më datë 14.05.2018, është përgjigje që merr shkas nga njoftimi që subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, i ka drejtuar Komisionit (datë 30.04.2018), në të cilën ajo shprehej se nuk është më subjekt i rivlerësimit, për të gjitha shkaqet e shtjelluara më sipër. Në kushtet kur kjo shkresë rezulton t'i jetë dërguar subjektit të rivlerësimit përpara hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues (15.03.2019) dhe fillimit të hetimit administrativ (21.03.2019), pavarësisht se përmbajtja e saj është me karakter informues, trupi gjykues vlerëson që ky shkëmbim nëpërmjet kryetares së Komisionit, është i parakohshëm dhe i pabazuar, pasi kërkimi i akteve, administrimi i provave dhe hetimi i çështjes janë kompetencë e trupit gjykues. Në kushtet kur subjektit të rivlerësimit iu dha mundësia të dëgjohej dhe të mbrohej në seancë gjyqësore publike, çdo pretendim i mundshëm për paanësi apo paragjykim për shkak të kësaj korrespondence vlerësohet e korrigjuar nga Kolegji.
39. Subjekti i rivlerësimit pretendon edhe se interpretimi i Komisionit në paragrafët 32 dhe 33 të vendimit është alogjik dhe i pabazuar, pasi gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk jep dorëheqjen te kryetari. Kjo e fundit nënkupton heqjen dorë nga një detyrë të cilën gjyqtari nuk e ka më. Trupi gjykues vëren se Komisioni³⁸ ka bërë një deduksion në kushtet që Kushtetuta [në nenin 136, pika 5] parashikon qëndrimin në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deri në emërimin e pasardhësit dhe faktin që subjekti i rivlerësimit ka njoftuar kryetarin e Gjykatës së Lartë për dorëzimin e detyrës pas mbarimit të mandatit, por nuk ka depozituar aktin e dorëheqjes. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky interpretim është i panevojshëm dhe tejkalon objektin e zbatimit të ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi, ky konstatim nuk zhbën analizën e përfundimet e shtjelluara gjerësisht më sipër, e konkretisht faktin që subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ka konfirmuar në mënyrë të pavesuar vullnetin për të mos vazhduar të ushtrojë detyrën e gjyqtares dhe, si rrjedhojë, ka hequr dorë nga ushtrimi i detyrës.
40. Subjekti i rivlerësimit pretendon më tej se Komisioni ka shkelur parimin e zhvillimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, interpretuar nga praktika e GjEDNj-së, në zbatim të nenit 6 të KEDNj-së, dhe shprehja e qëndrimit të saj për të mos konkurruar në një pozicion të gjykatës së apelit ka përbërë një situatë “stresuese” dhe penalizuese, pas “insistimit” të KLGj-së. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kronologjia e komunikimeve shkresore mes subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, Komisionit dhe KLGj-së, përmbledhur më sipër në paragrafët 31-34,

³⁸ Paragrafët 32 dhe 33 respektivisht: “[...]. 32. Rezulton se, zj. Evelina Qirjako, në datën 31.07.2017, ka njoftuar kryetarin e Gjykatës së Lartë për dorëzimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë për shkak të mbarimit të mandatit. Por, konstatohet se nuk është shprehur me akt për vullnetin e saj për dorëheqje, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 136 dhe nenit 139 të Kushtetutës. 33. Duket se kryetari i Gjykatës së Lartë, me gjithë mosdepozitimin e aktit të duhur të dorëheqjes, sipas parashikimit ligjor, ka interpretuar aktin e njoftimit për dorëzimin e detyrës si një “dorëheqje” të paraqitur nga znj. Evelina Qirjako, duke anashkaluar kërkesat e parashikuara në ligj [...]”

komunikime që përfshijnë një hark kohor njëvjeçar – prill 2018 deri në prill 2019 – përbëjnë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar pozicionin e saj *vis a vis* të ardhmes profesionale të subjektit. Konkretisht: i) subjekti i është drejtuar për herë të parë Komisionit më datë 30.04.2018 dhe sërish më datë 03.12.2018, mbi 7 muaj më pas; ii) Komisioni i ka kthyer fillimisht përgjigje subjektit më datë 14.05.2018 dhe në vijim të njoftimit të dytë të marrë nga subjekti i është drejtuar KLGj-së më datë 23.01.2019. Ndërkohë që më datë 21.03.2019, filloi procesi i rivlerësimit; iii) KLGj-ja më datë 03.04.2019 i është drejtuar subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, për të konfirmuar ushtrimin e së drejtës së saj brenda afatit 5-ditor nga marrja e shkresës. Në vijim të përgjigjes së subjektit, të përcjellë më datë 08.04.2019, KLGj-ja ka dhënë vendimin më datë 24.04.2019 për mbarimin e statusit të magjistratit, një vit pas letrës së parë të saj drejtuar Komisionit më datë 30.04.2018.

40.1. Nga sa më sipër, rezulton se procesi i shkëmbimit dhe vendimmarrjes për sa i përket procesit të rivlerësimit dhe statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit, duke qenë se ka zgjatur minimalisht një vit, përbën kohë të mjaftueshme për subjektin për të vendosur pa shqetësim në kuptim të kohës. Afati prej 5 ditëve i vendosur nga KLGj-ja në shkresën e datës 03.04.2019, për konfirmimin për caktimin në një pozicion në nivel apeli, nuk mund të argumentohet si “insistim” apo vënie e subjektit në situatë stresuese apo penalizuese për një çështje që ishte parashikuar tre vjet më herët nga ligji³⁹ nr. 96/2016 në mënyrë të shprehur, e ndërkohë vinte pas një viti shkëmbimesh shkresore. Ndonëse fillimisht shkëmbimet lidheshin me rivlerësimin, harku kohor dhe e drejta e parashikuar nga ligji shprehimisht për emërim në gjykatë apeli që në nëntor 2016, duhet të kishin përbërë mundësi për t’u përgatitur mjaftueshëm për vendimmarrje të pavarur nga rrethana të jashtme. Si rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar objektivisht. Pretendimi i subjektit se Komisioni ka shkelur parimin për zhvillimin e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme, mbetet i pabazuar në prova. Nga deklaratat e anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, rezulton se është konstatuar prej secilit prej tyre se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, dhe as vetë subjekti nuk rezulton të ketë shpjeguar në ankim shkaku apo arsyen se përse Komisioni ishte i njëanshëm në shqyrtimin e çështjes së saj. Megjithatë, në kushtet kur procesi ndaj subjekti të rivlerësimit iu nënshtrua shqyrtimit në seancë gjyqësore publike, çdo gabim procedural i Komisionit është korrigjuar nga Kolegji.

41. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, mbështet pretendimet e saj lidhur me mbarimin automatikisht të statusit të gjyqtarit në parashikimet e Kartës Evropiane mbi Statusin për Gjyqtarët. Ky i fundit parashikon se një nga situatat e përfundimit të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit është përfundimi i afatit të caktuar ligjor (pika 7.1), parashikim që nuk gjendet në nenin 64, pika 1 e ligjit nr. 96/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Karta Evropiane ka për qëllim të vendosë garanci kundër humbjes arbitrare të statusit, parë në sfondin e sigurisë së mandatit si një ndër garancitë e pavarësisë së gjyqësorit. Pika 7.1 e Kartës rekomandon që, me përjashtim të rasteve që kanë të bëjnë me rrethana të pakontestueshme – si mbërritja e moshës së pensionit apo mbarimi i mandatit – në procesin e vendimmarrjes për të ardhmen profesionale

³⁹ Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, datë 06.10.2016, hyrë në fuqi më 22.11.2016, parashikon shprehimisht në nenin 61, pika 4 që, pas mbarimit të mandatit 9-vjeçar, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë [sikurse edhe disa mbajtës funksionesh të tjera të specifikuar], kanë të drejtë të emërohen në një gjykatë apeli.

të magistratëve, të përfshihet një kontroll dhe garanci procedurale shtesë në funksion të pacenueshmërisë së statusit të gjyqtarëve, si themel i funksionimit të shtetit të së drejtës.

41.1. Këtë frymë të Kartës, legjislatori shqiptar e ka materializuar nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të KLGj-së dhe juridiksionit të tij në shërbim të garantimit të pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efikasitetit⁴⁰ dhe ligjit nr. 96/2016 që parashikon rregulla në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e magistratëve, përfshirë edhe zhvillimin e mbarimit të mandatit të magistratëve⁴¹.

41.2. Është me rëndësi të theksohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që potencon mbarim *automatik* të mandatit pa asnjë element shtesë kontrolli, bie ndesh me frymën e Kartës Evropiane, e cila ka për qëllim të parandalojë veprime abuzive nga ekzekutivi apo legjislativi nëpërmjet të cilave krijohen kushte për të larguar nga drejtësia nëpërmjet teknikalliteteve gjyqtarët dhe, në afat të gjatë, të parandalojë cenimin e pavarësisë së gjyqësorit. Me fjalë të tjera, në çdo këndvështrim të mundshëm, Karta sugjeron praktikën më të mira për vendet anëtare për të parandaluar largimin nga drejtësia të gjyqtarëve për arsye që nuk përbëjnë shkaqe objektive apo fakte të pakontestueshme, në përpjekje për të mbrojtur gjyqtarët individualisht dhe gjyqësorin si të tërë larg çdo ndikimi që minon pavarësinë e gjyqësorit. Karta është në vazhdimësi të një grupi standardesh ndërkombëtare, përfshirë Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësorit [Milano 1985], miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në të njëjtin vit⁴², ndër të tjera.

41.3. Pikërisht në zbatim të këtyre standardeve dhe interpretimit në praktikë të çfarë kërkohet për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit, materializuar në palëvizshmërinë nga detyra të gjyqtarëve, ligjbërësi ka sanksionuar garanci në formën e së drejtës së ushtrimit të detyrës nga gjyqtarët, pa u kushtëzuar nga mandatet, për sa kohë nuk kanë arritur moshën e pensionit dhe nuk gjenden në kushtet e shkeljes disiplinore. E anasjella do të ishte alogjike: që pavarësia e gjyqësorit të ishte vulnerabël për shkak të mungesës së garancive për karrierë e promovim, në mbarim të një mandati në një detyrë të caktuar. Në situatën e fundit hipotetike, për ekzekutivin apo legjislativin do të mjaftonte të shkurtonin mandatet për të ndëshkuar gjyqtarët e për të ruajtur kontrollin fundor mbi karrierën e magistratëve, duke bërë ndryshime në ligj në diskrecionin e tyre, që do të ishte situata faktike në të cilën GjEDNj-ja ka vendosur në çështjen Baka kundër Hungarisë⁴³.

41.4. Në përmbledhje, referimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, në Kartën Evropiane, në mbështetje të rrethanave të faktit në të cilat ajo ndodhet, përbën në fakt një përpjekje për të përdorur një garanci në të kundërtën e objektivit për të cilin ajo [Karta dhe parimet që ajo promovon] është dakordësuar. Mënyra e propozuar e interpretimit të Kartës nga subjekti i rivlerësimit do të nënkuptonte që edhe gjyqtarët që dëshirojnë të shërbejnë në sistemin e drejtësisë, do të jenë nën presionin e humbjes së statusit për shkaqe mandati, gjë që siç është shtjelluar më sipër në paragrafin 41.1, ligjvënësi e ka parandaluar me garancitë ligjore. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se mbarimi i statusit të subjektit të rivlerësimit,

⁴⁰ Objekti i ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 1.

⁴¹ Objekti i ligjit nr. 96/2016, neni 1, pika 1, germa "c".

⁴² Rezoluta 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe rezoluta nr. 40/196, datë 13 dhjetor 1985.

⁴³ Shih Baka kundër Hungarisë, <http://hudoc.echr.coe.int/fre?i=001-144139>, ndër të tjera, paragrafët 91-101.

znj. Evelina Qirjako, gjatë procesit rivlerësimit, me vullnetin e saj, është në përputhje të plotë edhe me garancitë e referuara prej saj për paprekshmërinë e mandatit të gjyqtarëve. Për këto arsye, ky pretendim është alogjik dhe i pabazuar.

42. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka përdorur standarde të dyfishta për situata të njëjta, duke referuar vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., apo rastet e gjyqtarëve që kanë dalë në pension pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Në këtë kontekst, referohen pjesë nga vendimi i Komisionit nr. 126, datë 27.02.2019⁴⁴, që lidhen me konkludimin që objekti për të cilin ka nisur procedura, është bërë i pamundur. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se kontrolli ligjor i vendimeve të Komisionit nga Kolegji kryhet vetëm nëpërmjet ankimit. Vendimi i referuar nuk është ankimuar në Kolegji⁴⁵ e, për pasojë, nuk mund të përbëjë objekt analize. Së dyti, duke abstraguuar nga rasti i znj. M. Xh., për shkak edhe të ndryshimit të mjeteve procedurale të cilat vunë në lëvizje Kolegjin në atë çështje, trupi gjykues i Kolegjit në një analizë në parim sjell në vëmendje se për subjekte të rivlerësimit që mbërrijnë moshën e pensionit, vazhdimi i procesit të rivlerësimit në nivel parimor mund të binte ndesh me kërkesat për efikasitet në rivlerësim, sidomos nëse rikthimi në drejtësi është teorikisht i pamundur në një nga pozicionet e parashikuara nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Duke u kthyer në rrethanat konkrete të faktit, nëse subjekti i rivlerësimit nuk do të shprehte dëshirën për të hequr dorë nga ushtrimi i mëtejshëm i detyrës, ajo do të vazhdonte të gëzonte statusin e magjistratit e, për pasojë, mungesa e vullnetit për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit do të duhej të interpretohej si bazë për zbatimin e nenit G të Kushtetutës.
43. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, pretendon se penalteti i parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës stigmatizon dhe ndikon drejtpërsëdrejti në jetën profesionale pasi jo vetëm që e përjashton atë nga organet e drejtësisë, por krijon probleme edhe në karrierën private, sikurse mësimdhënia, pjesëmarrja në projekte të caktuara dhe në borde të ndryshme etj. Trupi gjykues i Kolegjit vëren, së pari, se ky pretendim është përtej objektit të kontrollit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pasi është përcaktim kushtetues. Konkretisht, nën dritën e parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës⁴⁶, kushtetutshmëria e parimeve mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit, nuk është objekt diskutimi.

43.1. Së dyti, për sa i përket argumentit të subjektit që, ndonëse joliteralisht, përbën gjithsesi pretendim për ndërhyrjen në jetën private në kontekstin e nenit 8 të KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon një ndalim specifik për kryerjen e detyrave specifike, në raste të përcaktuara. Qëllimi i këtij ndalimi, ashtu si edhe të gjitha dispozitat kushtetuese e ligjore që rregullojnë rivlerësimin kalimtar, është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi⁴⁷. Së treti, subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të pasojave që rridhnin nga heqja dorë nga ushtrimi i detyrës, qoftë kjo e shprehur

⁴⁴ Lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. N. P.

⁴⁵ Shih edhe vendimin e Komisionerit Publik për mosankim, në:

<http://ikp.al/ep-content/uploads/2019/04/90.Njoftim-p%C3%ABr-mosankimin-e-vendimit-nr.-126-dat%C3%AB-27.3.2019-znj.-Nazmie-Pengili.pdf>.

⁴⁶ Neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe, si i tillë, bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj [...]”.

⁴⁷ Siç përcaktohet në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016.

edhe me mospranimin për t'u caktuar në një pozicion në gjykatë apeli, e drejtë e parashikuar në nenet 61 dhe 62 të ligjit nr. 96/2016. Së katërti, pretendimi i subjektit për interferim në karrierë private nuk ofron lidhje shkakësore bindëse mes dispozitës kushtetuese në fjalë dhe ndërhyrjeve të pretenduara prej saj në funksione të ndryshme private. Ky pretendim rezulton po ashtu i pabazuar në rrethanat konkrete – subjekti, siç është arsyetuar më sipër, zgjodhi dhe vazhdon të ushtrojë profesionin e lirë të avokatit që nga viti 2018.

43.2. Më tej, në analizë të kushtetutshmërisë së dispozitave që rregullojnë procesin e rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78/2017 ka konkluduar se ndërhyrja në jetën private për subjektet, është e justifikuar në balancë me interesin publik:

“[...] 42. Edhe në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private dhe familjare, gjykata vlerësoi se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë (shih paragrafin 64 të vendimit). [...]”

43.3. Në përmbledhje të sa më sipër, ndalimi i përcaktuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, i cili zbatohet për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë që, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, kanë fituar statusin e subjektit të rivlerësimit, parashikuar nga kushtetutëbërësi për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, i është nënshtruar një analize shteruese. Kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e procesit të rivlerësimit. Në të kundërt, ligjvënësi ka vendosur në nivel kushtetues ndalimin për rikthim në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15- vjeçare.

44. Subjekti i rivlerësimit argumenton se duhet vlerësuar proporcionaliteti i masës së dhënë me qëllimin e kërkuar. Ky pretendim është shtjelluar gjerësisht në jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit⁴⁸. Po ashtu, kushtetutshmëria e masës është analizuar në mënyrë shteruese nga Gjykata Kushtetuese⁴⁹. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në dritën e qëllimit për të cilin është ngritur sistemi i rivlerësimit, ndalimi i ushtrimit të detyrave në sistemin e drejtësisë për 15 vjet, nuk është disproporcional, për sa kohë shteti legjitimohet të sanksionojë ndalime të caktuara në fusha të caktuara të funksioneve publike. Pretendimi i subjektit se ndalimi i zbatuar për të është disproporcional, bie ndesh edhe me kriteret e përcaktuara nga GjEDNj-ja në lidhje me ndalimin me ligj për individë të caktuar për të kryer detyra të caktuara në sektorin publik. Sipas GjEDNj-së, në Niadin kundër Rumanisë:

“[...] Funksionarët publikë, sidomos ata që, si kërkuesi, kërkojnë të shërbejnë në pozicione si ai që kërkuesi ka dashur të kthehet, ushtrojnë një pjesë të sovranitetit të shtetit. Ndalimi i kërkuesit, për pasojë, nuk është disproporcional kundrejt objektivit

⁴⁸ Shih, ndër të tjera, vendimin e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Kana [JR nr. 39/2020], paragrafi 34, vendimin në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eneida Civici [JR nr. 41/2020], paragrafi 32.

⁴⁹ Shih, ndër të tjerë, paragrafin 63 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

legjitim të shtetit për të siguruar besnikërinë e atyre që mbajnë përgjegjësitë që shoqërohen me interesin e përgjithshëm. 55. Gjykata vëren se shteti nuk ka vendosur ndalime mbi punësimin e ardhshëm të kërkuesit në sektorin privat apo edhe në kompani që paraqesin njëfarë interesi për shtetin në çështje ekonomike [...]. Po ashtu, kërkuesit nuk i ndalohet punësimi në një fushë tjetër të sektorit publik, që nuk passjell/përfshin ushtrimin e funksioneve publike [...]”⁵⁰.

45. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit thekson se zbatimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës është pasojë ligjore e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për të gjithë subjektet e rivlerësimit, të cilët me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procesit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në funksion të kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Vendimi i Komisionit për të ndërprerë procesin dhe zbatimin e ndalimit nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është i bazuar. Për rrjedhojë, pretendimet dhe argumentet e subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, të shtjelluara më sipër, se në rastin e saj nuk ka vend për të konstatuar për dorëheqje, se mosaplikimi për një të drejtë ligjore nuk mund ta penalizojë dhe, për rrjedhojë, sanksioni i përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionit është i paparashikuar nga ligji, janë të pabazuara në ligj.
46. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, ka humbur statusin e magjstrates dhe ka shprehur vullnetin e saj të pavesuar për të mos iu nënshtuar procesit të rivlerësimit, siç u konfirmua edhe nga parashtrimet e saj në ankim dhe me qëndrimin përfundimtar në seancën gjyqësore publike të zhvilluar më datë 03.02.2021. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit shprehu dakordësinë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
47. Në mbështetje të legjislacionit të zbatueshëm dhe të jurisprudencës së tij të konsoliduar tashmë, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se mbarimi i statusit të magjstratit pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, pavarësisht datës kur ky fakt ka ndodhur, shkakton humbjen e kësaj cilësie të domosdoshme për të vijuar procesin e rivlerësimit, sipas nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
48. Përpos sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara gjatë procesit dhe qëndrimit të shprehur të subjektit të rivlerësimit, në zbatim edhe të parashikimit të nenit 45, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit konstaton situatën subjektive nëpërmjet vullnetit të shprehur me shkrim si një heqje dorë nga e drejta për të ushtruar detyrën e gjyqtarit në nivel gjykate apeli, në përputhje me nenin G, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit thekson se zbatimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës është pasojë ligjore e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për të gjithë subjektet e rivlerësimit, të cilët me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procesit të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në funksion të kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

⁵⁰ Paragrafët 54-55, Naidin kundër Rumanisë, në lidhje me ndalimin kategorik të individëve që të kryejnë detyra të caktuara në institucione të caktuara publike.

49. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë vendimin e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi mbarimi i statusit të magjistrates dhe vullneti i saj i pavesuar për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit sjellin si pasojë humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme për një periudhë 15-vjeçare.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 178, datë 08.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 12.02.2021.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Ne – gjyqtarët Albana Shtylla dhe Sokol Çomo – nuk jemi dakord me vendimin nr. 5, datë 12.02.2021, të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) për shqyrtimin e vendimit nr. 178, datë 08.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako. Nëpërmjet këtij vendimi, shumica e trupit gjykues vendosi të lërë në fuqi vendimin e sipërcituar të Komisionit. Ne gjyqtarët në pakicë kemi votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit për arsyet e mëposhtme.
2. Komisioni, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, me vendimin nr. 178, datë 08.07.2019, ka vendosur:
 1. *Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, është ndërprerë.*
 2. *Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. [...]*
3. Ky vendim i Komisionit është bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) nr. 66, datë 24.04.2019, me të cilin ky i fundit ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistrates, për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Evelina Qirjako, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli.
4. Me ankimin e paraqitur në Kolegji, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar pikën 2 të vendimit të Komisionit duke pretenduar se ajo nuk bazohet në fakte dhe në ligj.
5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, pasi është njoftuar nga Kolegji për shqyrtimin e ankimit të saj në dhomë këshillimi në datën 07.12.2020, i ka paraqitur trupit gjykues një kërkesë për pezullimin e gjykimit të çështjes, duke qenë se, nëpërmjet një padie të ngritur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kishte kundërshtuar pjesërisht vendimin e KLGj-së nr. 66, datë 24.04.2019, me objekt *shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ nr. 66, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistrates për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë Evelina Qirjako, për shkak të mbarimit të mandatit.* Subjekti i rivlerësimit kërkoi që kjo kërkesë të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike në prani të palëve, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar “ligji nr. 84/2016”) dhe nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
6. Gjatë gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni e kishte marrë vendimin nr. 178, datë 08.07.2019, duke mos e ftuar subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, në seancë dëgjimore sipas parashikimit të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se subjektit të rivlerësimit i ishte cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si pasojë e mohimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur. Për pasojë, trupi gjykues, me qëllim korrigjimin e këtij gabimi procedural të Komisionit, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vendosi gjithashtu që kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e shqyrtimit të çështjes nga Kolegji, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes gjyqësore që ishte duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ta merrte në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, në prani të subjektit të rivlerësimit.

7. Pasi trupi gjykues dëgjoi në seancë gjyqësore publike subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, vendosi që, nëpërmjet kërkesës drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të merrte informacion lidhur me statusin e gjykimit të kësaj çështjeje, duke shtyrë për rrjedhojë gjykimin në Kolegj në një seancë tjetër publike. Në seancën gjyqësore të radhës, trupi gjykues, pasi administroi në cilësinë e provave shkresore shkresën e Kolegjit drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit si më sipër përmendur dhe vërtetimin e Gjykatës Administrative të Apelit që konfirmonte faktin se çështja administrative e regjistruar pranë kësaj të fundit, me palë ndërgjyqëse subjektin e rivlerësimit, ishte në gjykim, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit se shqyrtimi gjyqësor i çështjes që lidhej me padinë e saj në Gjykatën Administrative të Apelit kishte përfunduar dhe vendimi ishte caktuar të shpallej në datën 26.01.2021, vendosi të pranojë kërkesën e subjektit për shtyrjen e seancës gjyqësore në një tjetër datë, pas datës në të cilën pritej shpallja e vendimit nga Gjykata Administrative e Apelit, lidhur me çështjen e sipërcituar.
8. Në seancën e radhës pranë Kolegjit, subjekti i rivlerësimit i paraqiti trupit gjykues vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit nr. 6, datë 26.01.2021, sipas të cilit kjo e fundit kishte vendosur pranimin e padisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, dhe ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 66, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke *deklaruar mbarimin e statusit të magjistrates për ish-gjyqtaren e Gjykatës së Lartë, znj. Evelina Qirjako, në datën 31.07.2017*. Në vijim, subjekti i rivlerësimit deklaroi se hiqte dorë nga kërkesa për pezullimin e procesit të saj në Kolegj dhe e konsideronte vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit të formës së prerë dhe, për rrjedhojë, kërkoi nga Kolegji vazhdimin e shqyrtimit të ankimit të ushtruar prej saj kundër pikës 2 të vendimit të Komisionit.
9. Ne, anëtarët në pakicë, bazuar në nenin 297, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, i kërkuam trupit gjykues pezullimin *ex officio* të gjykimit të çështjes deri në përfundimin e një kontrolli gjyqësor edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin eventual të ushtrimit të rekursit nga ana e palës së paditur, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për sa kohë në momentin e zhvillimit të seancës gjyqësore nuk kishte përfunduar ende afati procedural për ushtrimin e rekursit në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 6, datë 26.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo kërkesë nuk u pranua nga shumica e trupit gjykues, me arsyetimin se tashmë vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ishte i formës së prerë.
10. Në këto kushte, në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar nga Kolegji, për ne anëtarët në pakicë, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 6, datë 26.01.2021, i cili tashmë kishte marrë formë të prerë, bazuar në nenin 451/a, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, ishte i detyrueshëm për Kolegjin, sa i takon përcaktimit të shkakut të mbarimit të statusit të magjistrates për subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako. Për rrjedhojë, Kolegji nuk ka juridiksion dhe kompetencë të përcaktojë një shkak të ndryshëm për mbarimin e statusit të magjistratit në kundërshtim me një vendim gjyqësor të marrë nga Gjykata Administrative e Apelit, si i vetmi organ kompetent i ngarkuar nga ligji për kontrollin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 66, datë 24.04.2019, lidhur me mënyrën e mbarimit të statusit të magjistrates për subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako.
11. Në vlerësimin tonë, Kolegji, në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe në nenin F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, ka kompetencë të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit ndaj vendimeve të Komisionit, por jo ankimet ose pretendimet e magjistratëve kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë lidhur me mbarimin e statusit të tyre, edhe kur ato sjellin efekte të drejtpërdrejta në procesin e rivlerësimit kalimtar.
12. Për ne, gjyqtarët në pakicë, Kolegji nuk ka juridiksion të vlerësojë në rastin konkret çështjen lidhur me mbarimin e statusit të subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, në kushtet kur,

referuar nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është KLGj-ja organi kompetent për vendimmarrjen lidhur me të. Për sa i takon kontrollit gjyqësor të aktit administrativ individual të Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit të subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, referuar nenit 100⁵¹, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, këtë kompetencë e ka Gjykata Administrative e Apelit.

13. Në gjykimin tonë, vendimi i Komisionit objekt kontrolli bazohet dhe është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e vendimit të KLGj-së nr. 66, datë 24.04.2019, i cili aktualisht është ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 6, datë 21.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji nuk mund të përthithë kompetencën që ligjvënësi shprehimisht ia ka dhënë Gjykatës Administrative të Apelit, me interpretimin se në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, ai mund të bëjë edhe zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje gjyqësore administrative që ka lidhje të drejtpërdrejtë me këtë proces. Në gjykimin tonë, i takonte vetëm Gjykatës Administrative të Apelit të vlerësonte dhe të përcaktonte shkakun e mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit mund të kontrollohet në rast kundërshtimi nga palët vetëm nga Gjykata e Lartë, po për asnjë arsye Kolegji nuk mund të mos njohë dhe zbatojë vendimin e gjykatës kompetente.
14. Ky arsyetim i pakicës bazohet edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës, në trajtimin e çështjeve të ngjashme prej tij, si një nga parakushtet procedurale për marrjen e vendimeve në rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit në kuadër të zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka vlerësuar të domosdoshme që vendimet e KLGj-së lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit të kenë marrë formë të prerë.
15. Në kushtet kur sipas vendimit nr. 6, datë 21.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultoi se mbarimi i statusit të magjistrates për subjektin e rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, nuk ka ardhur për “shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion në nivel gjykate apeli”, sikurse konkludoi Këshilli i Lartë Gjyqësor në vendimin e tij nr. 66, datë 24.04.2019, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se nuk ndodhemi në kushtet e dorëheqjes nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako. Neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës rregullon pasojat juridike që rrjedhin vetëm në rastet e mbarimit të statusit të magjistratit si pasojë e dorëheqjes së tyre nga detyra. Për rrjedhojë, në gjykimin tonë në rastin konkret, ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Evelina Qirjako, nuk duhet të aplikohet ndalimi i parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi ynë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes mund të ishte krejt i ndryshëm, në rast se vendimi nr. 6, datë 21.01.2021, i Gjykatës Administrative të Apelit mbi të cilin ne bazojmë këtë qëndrim, do të ishte cenuar eventualisht nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në kuadër të kontrollit gjyqësor nga gjykatat kompetente. Për këtë arsye, ne insistuam në domosdoshmërinë e pezullimit të gjykimit të çështjes, deri në përfundimin e kontrollit të plotë gjyqësor administrativ të vendimit nr. 66, datë 24.04.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, eventualisht edhe nga Gjykata e Lartë⁵².

⁵¹ Neni 100, pika 1 e ligjit nr. 115/2016, në kohën e marrjes së vendimit të KLGj-së nr. 66, datë 24.04.2019, parashikonte:

“1. Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. [...]”.

⁵² Në momentin e arsyetimit të mendimit të pakicës, nga faqja zyrtare në internet e Gjykatës së Lartë, rezulton se pranë kësaj gjykate është regjistruar për shqyrtim një rekurs i Këshillit të Lartë Gjyqësor kundër vendimit nr. 6, datë 21.01.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit. Shih:

http://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2021-00707&ln=Lng1&uni=20210412124415134059351531442591.

16. Referuar situatës faktike dhe analizës ligjore të parashtruar si më lart, ne gjyqtarët në pakicë vlerësuam se e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes objekt gjykimi, në vlerësimin tonë ishte ndryshimi i vendimit të Komisionit nr. 178, datë 08.07.2019, nëpërmjet prishjes së pikës 2 të tij, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, alternativë për të cilën edhe votuam.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi